



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME  
DREJTORIA PER SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Nr: 07/35

Datë:10.05.2022

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Rregullores MF – NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 2, pika 5, neni 12, neni 13 shpall:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM**

**MBËSHTETJE FINANCIARE ME SUBVENCIONE PËR OJQ – të DHE SHOQATAT QË ZHVILLOJNË AKTIVITETE NË FUSHËN E MIRËQENIES SOCIALE DHE OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE.**

**Qëllimi i Thirrjes për Aplikim:**

Qëllimi i Thirrjes për Aplikim është dhënia e mbështetjes financiare me subvencione për OJQ-të dhe Shoqatat, për zbatimin e projekteve për zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare. Të gjitha Organizatat Joqeveritare (OJQ-të) dhe Shoqatat të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, mund të aplikojnë me projekt propozime për sigurimin e përkrahjes financiare me subvencione. Shuma për subvencionim të OJQ -ve është në vlerë prej 200 -5000 €

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat aplikojnë me projekt propozime , duhet të përcaktohen vetëm në një pikë.

Projektet të cilat do të marrin përkrahje financiare duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e këtyre shërbimeve sociale dhe familjare të përshkruara si më poshtë:

- a) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë: e personave me aftësi të kufizuara;
- b) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese dhe rehabilituese për Familjet e Dëshmorëve të UÇK-së;
- c) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për Veteranët e UÇK-së;
- ç) Shërbime mbështetëse dhe këshilluese, rehabilituese për invalidët e UÇK –së;
- d) Shërbime avokuese për të rinjtë për shmangie të sjelljeve devijante dhe dukurive negative me qëllim të formimit të mirfilltë të personalitetit të tyre intelektual;
- dh) Shërbime mbështetëse , sensibilizim dhe pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme rekreative për pensionistë dhe persona të moshuar.
- e) Shërbime mbështetëse, dhe strehim për viktimat e dhunës në familje
- f) Fushatë e vetëdijësimit për shëndetin publik



## Kualifikimi dhe dokumentet për aplikim

OJQ-të dhe Shoqatat të cilat kërkojnë mbështetje me subvencione duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, në Republikën e Kosovës.

OJQ-të dhe Shoqatat duhet të ofrojnë dëshmi për projektet e realizuara në të kaluarën dhe kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e mirëqenies sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.

Në projekt duhet specifikuar qartë qëllimi, objektivat, aktiviteti, përfituesit dhe buxheti. Përshkrimi i kapaciteteve menaxhuese të organizatës, personeli dhe përfshirja e ekspertëve në zbatimin e projektit.

## DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

1. Kopja e letërnjoftimit të Drejtorit (Kryetarit) Ekzekutiv të OJQ-së apo Shoqatës;
2. Projektpropozimi;
3. Tabela e buxhetit të projektit;
4. Kopja e certifikates së regjistrimit të OJQ-së apo Shoqatës;
5. Kopja e certifikates së numrit fiscal;
6. Kopja e xhirrollogarisë së OJQ-së apo Shoqatës;
7. Kopja e Statutit të themelimit të OJQ-së apo Shoqatës;
8. Kopja e licencës për OJQ-të dhe Shoqatat e licencuara nga MPMS-ja;
9. CV-të e stafit të angazhuar në zbatimin e projektit;
10. Përparësi kanë OJQ-të dhe Shoqatat të cilat janë të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale;

### Afati dhe procedura e aplikimit:

Afati për dorëzimin e Projektpropozimeve për mbështetje me subvencione është 15 ditë nga dita e shpalljes. Projektpropozimet me dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në Zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Objekti i Komunës, Kati III, çdo ditë pune nga ora 8:00-16.

Formularin për aplikim dhe informatat më të hollësishme rreth aplikimit mund të shkarkoni në Web të Komunës, dhe mund t'i merrni në Zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



Drejtori  
Dr. Isa Haxhiu